



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 274/25 Datë: 20.03.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 135 të mbajtur më 10.03.2025, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit Ekonomik, për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2025 - 30 shtator 2030):
 1. *Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, në gjuhën angleze, BSc 180 R me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës që deri me 30 shtator 2025, të dorëzojnë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti i Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, në gjuhën angleze, BSc 180 R</i>	But Dedaj Nimete Berisha Gazmend Qorraj

Faqe 1 nga 2

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës me ekspertë të jashtëm ndërkombëtarë të akreditimit.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- **Për programin e studimit; *Ekonomi e Aplikuar dhe Menaxhment, në gjuhën angleze, BSc 180 R***, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: *Andrea Serban, Marina Gregoric dhe Giga Khositashvili* është organizuar me 30.01.2025 ku gjatë vlerësimit ky program është vlerësuar se i përmbushë Plotësisht tre (3) fusha të standardeve të akreditimit dhe Substantialisht katër (4) fusha të standardeve të përcaktuara me Rregullorja (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 135-të, të mbajtur më datë 10.03.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të akreditimit të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës dhe duke u bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimet përfundimtar të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.